



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.44, datë 23.02.2023

PËR
“KOMANDIMIN E PROKURORIT NË POZICIONIN E KËSHILLTARIT
LIGJOR, PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 53 dhe 54 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 176 pika 3, 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Komandimin e zotit Gentian Habazaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në pozicionin e Këshilltarit Ligjor, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Afati i komandimit fillon në datën 15.03.2023 dhe përfundon në datën 14.03.2028.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Gentian Habazaj, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 23.02.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Coxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza